



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 136

NR. VENDIMI 5322

V E N D I M

“Në emër të Republikës“

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: ANILA KRISTANI

asistuar nga sekretare Eralda Bendo sot më datë 20.06.2018, pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr.19296/6191/799/286/185/136 regj.them, që i përket:

**PADITES :**                   \*\*\*, me seli \*\*\*, me NUIS \*\*\*, përfaqësuar në gjykim sipas prokurës së posaçme datë \*\*\* me nr. \*\*\*, nga av. \*\*\* dhe av. \*\*\*, dhe sipas autorizimit datë \*\*\* nga av. \*\*\*.

**I PADITUR:**               \*\*\*, me seli në \*\*\*, përfaqësuar në gjykim sipas autorizimit pa datë nga av. \*\*\* dhe av. \*\*\*, me NUIS \*\*\*.

**PERSON I TRETË:** \*\*\*, person fizik regjistruar me NUIS \*\*\*, me adresë \*\*\*.

- OBJEKTI :**
1. Deklarimi i paligjshëm i aktivitetit tregtar të importimit dhe qarkullimit në tregun shqiptar të produkteve “\*\*\*” për shkak se përbën aktivitet që përfshihet në konkurrencën e pandershme dhe pushimi i cënimit të të drejtave të markës tregtare “\*\*\*” të paditësit.
  2. Ndalimi i të paditurit të importojë /eksportojë ,hedhë në tregun shqiptar, ofrojë për shitje ose krijojë rezerva për këto qëllime, patatina “\*\*\*” , si dhe çdo produkt tjetër që mbart imitime të markës tregtare dhe të dizenjës së patatinave të paditësit.
  3. Ndalimi i të paditurit të ofrojë shërbime dhe të përdorë në veprimtari tregtare, në reklamime ose publicitete etiketën “\*\*\*”.
  4. Bllokimi dhe shkatërimi me shpenzimet e të paditurit të të gjithë produkteve patatina “\*\*\*” të imortuara dhe të shpërndara në tregun shqiptar (me pakicë ose shumicë) nga i padituri dhe që mund të gjenden tek çdo subjekt tregtar ose në magazina ose në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë.
  5. Urdhërimin e të paditurit të japë informacion në lidhje me orgjinën dhe rrjetin shpërndarës të patatinave “\*\*\*” që çenojnë markën tregtare “\*\*\*”.
  6. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin ne shumën prej \*\*\*lekë si zhdëmtin për humbjen e të ardhurave nga mosshitja e patatinave “\*\*\*” (\*\*\*) (\*\*\* lekë secila).
  7. Detyrimin e të paditurit të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore duke përfshirë edhe pagesat e kryera nga paditësi për shërbimet juridike.

**BAZA LIGJORE:** Neni 156, 167,168, 170/4 ë ligjit nr.9947 “Për pronësinë industriale”, nenet 608 e vijues ,638, 639, 640, 644 të Kodit Civil, si dhe neni 348 i K Pr Civile.

**Në konkluzionet përfundimtare:**

**Paditësi** kërkoi pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj,  
**I padituri** dhe personi i trtë e lanë gjykimin në mungesë;  
**Gjykata** pasi administroi provat, deklaroi të mbyllur hetimin gjyqësor, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palës prezente;

**V E R E N**

**Pala paditëse**, fillimisht i ishte drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë me objekt të saj :

- 1.Pushimi i cënimit të të drejtave industriale të paditësit që rrjedhin nga marka tregtare “\*\*\*\*”.
  - 2.Deklarimi i paligjshëm i aktivitetit tregtar të importimit dhe qarkullimit në tregun shqiptar të produkteve “\*\*\*\*” pasi përbën një aktivitet që përfshihet në konkurrencën e pandershme.
  - 3.Ndalimi i të paditurit të importojë /eksportojë ,hedhë në tregun shqiptar, ofrojë për shitje ose krijojë rezerva për këto qëllime, patatina “\*\*\*\*”, si dhe çdo produkt tjetër që mbart imitime të markës tregtare dhe të dizenjosh së patatinave të paditësit.
  - 4.Urdhërimi i të paditurit të japë informacion në lidhje me orgjinën dhe rjetin e shpërndarës së patatinave “\*\*\*\*” që cënojnë markën tregtare \*\*\*.
  - 5.Ndalimi i të paditurit të ofrojë shërbime dhe të përdorë në veprimtari tregtare , në reklamime ose publicitete etiketën “\*\*\*\*”,
  - 6.Bllokimi dhe shkatërimi me shpenzimet e të paditurit të të gjithë produkteve patatina “\*\*\*\*” të imortuara dhe të shpërndara në tregun shqiptar (me pakicë ose shumicë) nga i padituri dhe që mund të gjenden tek çdo subjekt tregtar ose në magazina ose në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë.
  - 7.Urdhërimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin në shumën prej \*\*\*lekë si zhdëmtin për humbjet e të ardhurave nga mosshitja e patatinave “\*\*\*\*” (\*\* lekë secila).
  8. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin ne shumën prej \*\*\* lekë si zhdëmtin për dëmet morale /jopasurore për shkak të cënimit të reputacionit dhe emrit të mirë të markës së paditësit si pasojë e veprimtarisë së paligjshme të të paditurit.
  - 9.Detyrimin e të paditurit të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore duke përfshirë edhe pagesat e kryera nga paditësi për shërbimet juridike siç do të bëhen.
- Pas kërkesës për ndryshimin e objektit të kërkesëpadisë, kërkesë e cila si u gjet e bazuar në nenin 185 të K Pr Civile u pranua nga gjykata, rezultoi se i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë objekt gjykimi, duke kërkuar :
- “1.Deklarimi i paligjshëm i aktivitetit tregtar të importimit dhe qarkullimit në tregun shqiptar të produkteve “\*\*\*\*” për shkak se përbën aktivitet që përfshihet në konkurrencën e pandershme dhe pushimi i cënimit të të drejtave të markës tregtare “\*\*\*\*” të paditësit.
  - 2.Ndalimi i të paditurit të importojë /eksportojë ,hedhë në tregun shqiptar, ofrojë për shitje ose krijojë rezerva për këto qëllime, patatina “\*\*\*\*”, si dhe çdo produkt tjetër që mbart imitime të markës tregtare dhe të dizenjosh së patatinave të paditësit.
  - 3.Ndalimi i të paditurit të ofrojë shërbime dhe të përdorë në veprimtari tregtare , në reklamime ose publicitete etiketën “\*\*\*\*”,
  - 4.Bllokimi dhe shkatërimi me shpenzimet e të paditurit të të gjithë produkteve patatina “\*\*\*\*” të imortuara dhe të shpërndara në tregun shqiptar (me pakicë ose shumicë) nga i

padituri dhe që mund të gjenden tek çdo subjekt tregtar ose në magazina ose në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë.

5. Urdhërimin e të paditurit të japë informacion në lidhje me orgjinën dhe rrjetin shpërndarës të patatinave “\*\*\*\*” që çenojnë markën tregtare “\*\*\*\*”.

6. Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin në shumën prej \*\*\*lekë si zhdëmtin për humbjen e të ardhurave nga mosshitja e patatinave “\*\*\*\*” (\*\*\*lekë secila).

7. Detyrimin e të paditurit të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore duke përfshirë edhe pagesat e kryera nga paditësi për shërbimet juridike.”

Paditësi është shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar si e tillë në datën 18.04.2000, me objekt të veprimtarisë së saj: import eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale ushqimore etj .

Dhe shoqëria e paditur është shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar si e tillë në datën 30.03.2004, me objekt të veprimtarisë së saj: import eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore ,industriale etj .

Ndërkohë që personi i tretë në gjykim është regjistruar si subjekt tregtar në formën e personit fizik, i regjistruar si i tillë në datën 04.03.2008 me objekt të veprimtarisë së tij tregtim me pakicë të artikujve ushqimorë etj.

Gjatë hehtimit gjyqësor të çështjes, gjykata me vendimin e datës 15.04.2014, vendosi: “1.Pezullimin e gjykimit të çështjes deri në shqyrtimin e çështjes me nr. \*\*\*pranë Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe të procedimit penal regjistruar me nr. \*\*\* viti \*\*\*pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec në ngarkim të shtetasit z. \*\*\*.

Rezultoi se pala paditëse hoqi dorë nga e drejta e ankimit ndaj këtij vendimit të datës 15.04.2014 dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 30.09.2014 vendosi: “Pushimin e shqyrtimit të çështjes.”

Pas rënies së shkaqeve të pezullimit për të cilat nga an e gjykës ishte marrë vendimi i datës 15.04.2014, gjykata konformë parashikimit të bërë në K Pr Civile vazhdoi gjykimin e çështjes aty ku ishte pezulluar.

Gjatë hetimit gjyqësor, u kërkua përsëri pezullimi i gjykimit të çështjes, tashmë për një shkak të ri pezullimi, dhe gjykata me vendimin e datës 12.10.2015, vendosi:

“1.Pezullimin e gjykimit të çështjes deri në shqyrtimin e çështjes me nr. \*\*\* regjistruar në datë \*\*\*pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.

Pas ankimit të ushtruar ndaj vendimit të datës 12.10.2015 Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 24.02.2017 vendosi:

“Lënien në fuqi të vendimit me nr. \*\*\* akti datë \*\*\*të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Gjykata Administrative e Shkalës së Parë Tiranë me vendimin e datës \*\*\*me nr. \*\*\*, me palë paditëse në gjykim shoqërinë “\*\*\*\*”sh.p.k, të paditur Drejtorinë e përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe person të tretë në gjykim shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k, kishte vendosur:

“Pranimin e padisë shfuqizimin e aktit administrativ në trajtën e Vendimit të Bordit të Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave nr. \*\*\*datë

**\*\*\*që pranon regjistrimin e markës “\*\*\*” me numër aplikimi \*\*\* si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe detyrimin e palës së paditur të shprehet me vendim për refuzimin e regjistrimit të kësaj marke.”**

**Rezultoi se Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë mori në shqyrtim çështjen civile me nr. \*\*\* regjistruar në datë \*\*\* dhe me vendimin e datës 07.09.2017, vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. \*\*\* datë 11.05.2015”.**

**Pas rënies së shkaqeve të pezullimit për të cilat nga ana e gjykatës ishte marrë vendimi i datës 12.10.2015 , gjykata konformë parashikimit të bërë në K Pr Civile vazhdoi gjykimin e çështjes aty ku ishte pezulluar.**

**Sipas akteve të administruara rezultoi se:**

**Në rrethanat e sipërcituara paditësi, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi duke pretenduar se:**

**Paditësi ushtron veprimtari të tij tregtare në prodhimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë të llojit patatina nën markën tregtare “\*\*\*”, të cilën e ka të regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (ish DPPM) në klasën 29 të Klasifikimit të Nicës si markë fjalë dhe figurë me certifikatë regjistrimi 14723 dhe si markë fjalë “\*\*\*” me certifikatë regjistrimi me nr.14808.**

**Si pronare e ligjshme e kësaj marke paditësi gëzon të gjitha të drejtatqë i njuh ligji nr.9947 /2008.**

**I padituri në datën 29.10.2013 ka lidhur një kontratë me një shoqëri maqedonase “\*\*\*” ku objekt i kontratës ishte blerja e përnuajshme e një sasive patatinash me etiketën tregtare “\*\*\*” dhe tregtimi i tyre në tregun shqiptar.**

**Ky fakt provohet dhe nga deklarata doganore e datës 08.06.2013 sipas përmbajtjes së të cilës rezulton se është brë zhdoganimi i produktit të emërtuar pufka misri (\*\*\*) nga shoqëria e paditur me peshë neto 3726.72 kg me vlerë \*\*\* euro.**

**Sipas deklaratës doganore të datës 30.06.2013 sipas përmbajtjes së të cilës rezulton se është brë zhdoganimi i produktit të emërtuar pufka misri (\*\*\*) nga shoqëria e paditur me peshë neto 3749.76 kg me vlerë \*\*\* euro.**

**Futja e mallit në territorin shqiptar është bërë me procedurë tranziti nëpërmjet pikës doganore Qafë -Thanë dhe zhdoganimi është kryer në Durrës.**

**Në datën 29.07.2013 pasi konstatuan se në tregun shqipra ishin hedhur këto produkte të cilit ishin pothuaj identike me markën e tij paditësi paraqiti pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kërkesën për miratimin e aplikimit për veprim mbi mbrojtjen e të drejtave të tija të pronësisë industriale me qëllim ndalimin e hyrjes së produkteve të tjera identike ose të ngjashme me etiketën “\*\*\*”.**

**Në këto kushte në pamundësi për të futur në territorin e Republikës së Shqipërisë produktet e kundërligjshme si pasojë e bllokimit të vendosur nga ana e autoriteteve doganore i padituri përfshiu një tjetër person në këtë veprimtari të kundraligjshme që është personi i tretë në gjykim, i cili është një subjekt tregtar në formën e personit fizik. Kështu pavarësisht masave të ndërmarra nga paditësi dhe veprimeve të autoriteteve doganore i padituri ka vijuar të ekspertojë dhe të tregtojë këtë produkt në mënyrë të paligjshme nëpërmjet personit të tretë. Deklarimi i produkteve në Degën Doganore Durrës nuk është bërë nën emrin “\*\*\*” por produkte e kundraligjshme janë futur në territorin shqiptar nën emërtimin “\*\*\*” Emërtimet e përdorura në deklarata**

zhdoganimit provojnë se të dyja këto shoqëri kanë vepruar në bashkëpunim me njëra tjetrën për të futur këtë produkt i cili ligjërisht nuk mund të importohet për shkak të masve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në mbrojtje të të drejtave të pronësisë industriale të paditësit.

Futja e këtyre produkteve në mënyrë të kundraligjshme ka vazhduar të kryhet nga personi i tretë dhe rezulton se sasia e patatinave të futura në teritorrin shiptar nëpërmjet personit të tretë është e njëjtë me sajinë e përcaktuar në kontratën e lidhur më parë nga i paditurio me shoqërinë maqedonëse “\*\*\*\*”. Për këto arsye veprimet e kryera nga këto subjekte tregtare provojnë se emërtimi “\*\*\*\*” është bërë për të fshehur të dhënat e sakta me qëllim mashtrimin e subjekteve shtetërore dhe futjen në mënyrë të kundraligjshme të këtij produkti.

Importimi i produktit “\*\*\*\*” nga ana e personit të tretë , pas hyrjes në fuqi të vendimit mbi miratimin e kërkesave për veprim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave , vërtetohet me deklaratën doganore me nr. \*\*\* datë 04.09.2013 sipas të cilës ka kaluar një ngarkesë prej \*\*\* qesesh të emertuara \*\*\* (\*\*\*\*) në masën 4315.47 kg., certifikata e zhvendosjes me nr. \*\*\* dhe fatura me nr. \*\*\* datë 04.09.2013 me përshkrimin \*\*\* dhe \*\*\* me vlerë totale \*\*\* euro. Edhe në këtë rast importimi i mallit është bërë nëpërmjet procedurës së tranzitit duke përdorur emrin e personit të tretë.

Markat e paditësit gëzon të drejta mbrojtje ne kuptim të ligjit nr.9947/2008 dhe në aspektin vizual, është shumë e ngjashme me produktin e hedhur në treg nga i padituri dhe personi i tretë, dhe ky është një veprim në shkelje flagrante të konkurrencës së ndershme dhe të drejtave të pronësisë industriale. Nga një vështrim i shpejtë dhe në aspektin vizual këto produkte janë shumë të ngjashmedhe dallimet midis tyre janë të papërfillshme. Një konsumator me vëmendje mesatare e ka shumë të vështirë madje të pamundur të dallojë produktet nga njëra tjetra duke bërë atë të mendojë se ka përpara të njëjtin produkt gjë që shkakton konfuzion të hapur në radhët e konsumatorëve.

Nga deklarata doganore me nr. \*\*\* datë 08.06.2013 dhe ajo me numër \*\*\* datë 30.06.2013 rezulton se i padituri ka importuar për tregun shqiptar respektivisht 3726.72 kg në 1941 kol në vlerë totale \*\*\*euro dhe 3749.76 kg në 1953 thasë me vlerë totale \*\*\*euro të produktit \*\*\*.

Gjithashtu i padituri ka përdorur shërbimin e personit të tretë me qëllim importimin e \*\*\* mashtruese fakt që provohet nga deklarata doganore me nr. \*\*\* datë 04.09.2013, për sasinë 4315.47 kg me vlerë \*\*\*euro.

Në kushtet kur i padituri dhe personi i tretë kanë importuar dhe shërndarë në vend produkte me ngjashmëri identike me produktet e markës “\*\*\*\*”, për pasojë paditësi ka pësuar dhe një dëm ekonomik të konsiderueshëm që konsiston në humbjen e të ardhurave dhe fitimin e munguar nga mosshitja e 11791.95 kg patatina \*\*\*, kjo sasi rezulton nga mbledhja matematikore e sasisë së patatinave të futura sipas tre deklaratave doganore. Cmimi i patatinave orgjinale të paditësit është \*\*\* lekë për një qese , një qese patatine orgjinale përmban 30 gram ose 0,3 kg patatina. Duke pasur parasysh sasisë e patatinave të hedhura në treg prej 11 791.95 kg pjestuar për masën e një qeseje të patatinave orgjinale prej 0,3 kg atherë do të kemi 39 306, 5 qese patatinash. Duke pasur parasysh velrën e një qeseje të patatinave orgjinale prej \*\*\* lekë copa atherë demi ekonomik shkakuar paditësit do të ishte në masën prej 39 306,5 qese patatina të pashituara duke i shumëzuar me velrën e një qeseje , vlera është në masën \*\*\*lekë.

Kjo velrë është llogaritur vetëm mbi bazën e të dhënave të pasqyruara në tre deklarata

doganore të cilat nuk janë kontestuar nga i padituri apo personi i tretë.

I padituri kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë por nuk akdhënë ndonjë prapsim konkret lidhur me çështjen në gjykim. Po kështu dhe personi i tretë në gjykim në seancat që ka qenë prezent ka vlerësuar të mos japë pretendime lidhur me çështjen, ndërkohë që nuk është paraqitur më në seancat në vazhdim.

Gjykata pasi u njoh me çështjen, çmon se kërkesëpadia e paraqitur është pjesërisht e bazuar në ligj dhe në prova.

Rezulton se shoqëria paditëse ushtron aktivitet tregtar që lidhet me prodhimin, tregtimin dhe shitjen me shumice e pakice të artikujve ushqimorë etj.

Një ndër produktet që prodhon dhe tregton shoqëria paditëse janë patatinat e markes tregtare “\*\*\*\*”, marke të cilën e ka regjistruar rregullisht në ish Drejtorinë e Pergjithshme të Patentave dhe Markave në klasen 29 të Klasifikatorit të Nices, si marke fjale dhe figure, me numer regjistrimi \*\*\*. Paditësi ka regjistruar gjithashtu marken \*\*\*, si marke fjale, me numer regjistrimi 14808.

Te dyja markat kanë fituar mbrojtje që nga data e aplikimit të tyre, konkretisht marka fjale \*\*\* rezulton se gëzon mbrojtje duke filluar nga data 12.09.2012, ndërsa marka fjale dhe figure gëzon mbrojtje duke filluar nga data 14.09.2012.

Me pas, paditësi është vënë në dijeni se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k me seli në Rrogozhinë - Kavaje, ka aplikuar tek ish Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave për regjistrimin si marke të shënjes “\*\*\*\*”.

Marka e kundërshtuar është publikuar në buletinin e ish Drejtorisë së Pergjithshme të Patentave dhe Markave numer \*\*\* dhe date publikimi 06.01.2014.

Me datën 25.03.2014, pala paditëse ka depozituar kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të markes së kundërshtuar “\*\*\*\*” në Bordin e Apelit pranë ish Drejtorisë së Pergjithshme të Patentave dhe Markave.

Kundërshtimi i paditësit ndaj markes së kundërshtuar e të publikuar të të paditurit është shqyrtuar nga Bordi i Apelit, i cili me aktin administrativ vendimin nr. \*\*\*, date 18.11.2014, ka vendosur të rrefuzojë kundërshtimin për regjistrimin e markes së kundërshtuar “\*\*\*\*”(fjale), duke lejuar vazhdimin e procedurave për regjistrimin e saj.

Në rrethanat e sipërcituara shoqëria paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt të saj shfuqizimi i vendimit të Bordit të Apelit nr. \*\*\*, date 18.11.2014 të ish Drejtorisë së Pergjithshme të Patentave si dhe refuzimi i regjistrimit të markes kombëtare \*\*\*, me numer aplikimi \*\*\* ;si dhe detyrimi i ish Drejtorisë së Pergjithshme të Patentave të refuzojë regjistrimin e markes kombëtare \*\*\*, me numer aplikimi \*\*\* në regjistrin e markave.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pasi ka marrë në shqyrtim çështjen ka konstatuar se produktet e markes së kundërshtuar \*\*\*, të cilat janë “Patatina” janë identike me klasen e mallrave të markave të mëparshme \*\*\* dhe për rrjedhojë, mallrat e markes \*\*\* janë plotësuese dhe konkurrenë me mallrat e markes \*\*\* në treg. Gjithashtu, duke përfaqësuar mallra identike, është konstatuar se këto mallra kalojnë neper të njëjtave kanale të shpërndarjes e furnizimit dhe tregtohen në të njëjtat njësi tregtimi, si dhe vendosen e reklamohen në të njëjtat seksione apo nendarje dhe se kjo e rrit edhe më tej mundësinë e konfuzionit në radhët e konsumatorëve.

Gjithashtu gjykata argumenton në vendimin e saj se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me aplikimin për regjistrimin e shënjes “\*\*\*\*” në mënyrë të qartë kërkon të krijojë një avantazh të padrejtë duke cenuar interesat e ligjshëm pasurore të shoqërisë paditëse, pasi aplikimi i tij qartësisht i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 143 i ligjit “Për

**Pronesine Industriale” e pikerisht për shkak të ngjashmerisë mes shenjave dhe ngjashmeria mes mallrave/sherbimeve.**

**Në përfundim Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë me vendimin me nr. \*\*\* datë 11.05.2015 ka vendosur:**

**“Shfuqizimin e aktit administrativ ne trajten e Vendimit te Bordit te Apelimit prane Drejtorise se Pergjithshme te Patentave dhe Markave Nr. \*\*\*, date 18.11.2014 qe pranon rregjistrimin e markes “\*\*\*\*” me numer aplikimi \*\*\* si te pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe detyrimin e pales se paditur te shprehet me vendim per refuzimin e rregjistrimit te kesaj marke.**

**-Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe ne castin kur merr forme te prere ekzekutohet ne menyre te drejteprejte nga Zyrat e Permbarimit ne Republiken e Shqiperise.”**

**Ky vendim bazuar mbi të njëjët argumenta është lënë në fuqi dhe nga Gjykata Administrative Apelit.**

**Në këto rrethana gjykata vlerëson se pretendimi i palës paditëse se në tregun shqiptar ishin hedhur produkte me etiketën “\*\*\*\*” të cilat janë të ngjashme me produktet, patatina të tregtuara prej tij nën markët e tij tregtare të mbrojtur është një përfundim të cilin e ka zgjidhur gjykata me një vendim të formës së prerë dhe është një pretendim që në vlerësimin e kësaj gjykate përbën gjë të gjykuar.**

**Në interpretim dhe zbatim të nenit 451/a të K. Pr. Civile, vendimi gjyqësor i formës së prerë që e ka zgjidhur çështjen në themel, përbën një zgjidhje të natyrës përfundimtare dhe të qëndrueshme të mosmarrëveshjes s’i në kuptimin konstituiv, ashtu dhe atë prekluziv.**

**Në kuptimin konstituiv, ai jep zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pozitave të palëve të kundërta në atë gjykim, ndërsa në kuptimin prekluziv ndalohet mundësia e kërimit në gjykatë të ndryshimeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë. E thënë ndryshe autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimi i procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t’i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe të vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi (res iudicata est).**

**Në kuptimin objektiv, gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me të njëjtin objekt të padisë dhe të njëjtin shkak ligjor (causa petendi) të saj, ndërsa në kuptimin subjektiv gjëja e gjykuar qëndron në lidhje me faktin që ajo që është vënë në bisedim (kërkimet, pretendimet, prapsimet), sipas parimit të kontradiktorialitetit dhe që është vendosur në gjykim me anë të urdhërimeve të vendimit, është e detyrueshme vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse në gjykim, trashëgimtarët e tyre dhe personat që tërheqin të drejta nga palët, fakt ky i cili të shpie në përfundimin se arsyeja, mjete juridik nëpërmjet të cilit ligji mbështet dhe përcakton pakundërshtueshmërinë e asaj që vërtetohet dhe disponohet me vendimin e formës së prerë, është efekti prekluziv, ndalues për ringritjen dhe përsëritjen e parashtrimit në gjykatë të kërkimeve dhe prapsimeve të bëra apo që mund e duhet të ishin bërë rreth mosmarrëveshjes gjatë gjykimit, dhe për të cilat gjykata përfundimisht ka vendosur në zbatim të vullnetit të ligjit.**

**Fuqia e “gjësë së gjykuar” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në gjykim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron gjykata në dispozitivin e vendimit të saj.**

**Në këto rrethana gjykata vlerëson se kërkimet e palës paditëse për deklarimin si të paligjshëm të aktivitetit tregtar të importimit dhe qarkullimit në tregun shqiptar të produkteve “\*\*\*\*”, ndalimi i të paditurit të importojë /eksportojë, hedhë në tregun**

shqiptar, ofrojë për shitje ose krijojë rezerva për këto qëllime, patatina “\*\*\*\*”, si dhe çdo produkt tjetër që mbart imitime të markës tregtare dhe të dizenjës së patatinave të paditësit, ndalimi i të paditurit të ofrojë shërbime dhe të përdorë në veprimtari tregtare, në reklamime ose publicitete etiketën “\*\*\*\*” si dhe bllokimi dhe shkatërimi me shpenzimet e të paditurit të të gjithë produkteve patatina “\*\*\*\*” të imortuara dhe të shpërndara në tregun shqiptar (me pakicë ose shumicë) nga i padituri dhe që mund të gjenden tek çdo subjekt tregtar ose në magazina ose në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë, dhe urdhërimin e të paditurit të japë informacion në lidhje me orgjinën dhe rrjetin shpërndarës të patatinave “\*\*\*\*” që çënojnë markën tregtare “\*\*\*\*” janë të bazuar në prova dhe ligj, në kushtet kur mallrat e tregtuara patatina nën markën “\*\*\*\*” çënojnë markën tregtare në pronësi dhe të mbrojtur të shoqërisë paditëse. Pala paditëse me kërkesëpadinë drejtuar gjykatës ka kërkuar dhe detyrimin e të paditurit ta dëmshpërblejë për dëmin e pësuar në masën si më sipërcituar. Në kuptim të nenit 608 të Kodit Civil që të jemi para përgjegjësisë juridiko- civile të demit pasuror jokontraktor duhet që të egzistojnë në mënyrë kumulative të katër këto elemente dhe konkretisht:

a) dem i shkaktuar është rezultat i një veprimi të paligjshëm.

Veprimi i paligjshëm, në kuptim të nenit 608/2 i KC, çësohet çdo veprim që është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe të drejtave të tjetrit që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Mbeshtetur në aktet e administruara në gjykim pasi analizoi dinamiken e ndodhjes së ngjarjes çmon se veprimet e paligjshme janë veprimi i importimit dhe tregtimit të produkteve patatina nën një markë tregtare të ngjashme me atë në pronësi të paditësit.

b) ekziston dem pasuror.

Demi pasuror në kuptim të dispozitave të Kodit Civil përfaqëson humbjen e pësuar si rezultat i uljes së vlerës së pasurisë.

Lidhur me percaktimin e vlerës së demit shkaktuar paditësit gjatë gjykimit u administruan deklaratat doganore të cilat shprehnin sasisinë e mallit të importuar, në dy raste sipas deklaratës doganore e datës 08.06.2013 dhe ajo e datës 30.06.2013 nga shoqëria e paditur dhe në një rast nga personi i tretë në gjykim sipas deklaratës doganore të datës 04.09.2013. Paditësi pretendoi se dem i ardhur atij është në masën \*\*\* lekë, shumë kjo e cila përfaqëson vlerën që ai do të kishte përfituar në rast se do të kishte shitur këtë sasi patatinash të importuara. Por vlera e demit të ardhur paditësit në formën e fitimit të munguar nuk mund të jetë në këtë masë, pasi kjo vlerë, përfaqëson ashtu si dhe vetë paditësi pretendon, vlerën që do të kishte përfituar nga shitja, por nuk përfaqëson fitimin që shoqëria do të realizonte sikur të kishte shitur 39 306, 5 qese patatinash. Po kështu nga pala paditëse nuk u paraqit as edhe një provë shkresore lidhur me aktivitetin e saj ekonomik, lidhur me faktin se si do të kishte ndikuar kjo ngjarje në kohën në të cilën ka ndodhur, apo cili ishte fitimi i realizuar nga shoqëria e paditur etj. Shoqëria paditëse lidhur me vlerën e demit u mjaftua vetëm me prezumim se ajo duhet të ishte në vlerën që do të ishte përfituar nga shitja e patatinave të importuara në mënyrë të paligjshme. Por vlera e përfituar nga shitja e tyre nuk mund të përbëjë dëmin e pësuar në formën e fitimit të munguar për shoqërinë paditëse as në kuptim të provave dhe as në kuptim të ligjit konkretisht parashikimit të bërë nga neni 184/c i ligjit nr.55/2014.

c) ngjarja e sigurimit është kryer me faj, në formën e dashjes së plotë.

Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm konsiderohet i kryer me faj, kur ai është pasoje e krijimit me dashje ose nga pakujdesia e rrethanave, që sjellin drejteperdrejte dhe në mënyrë të menjehershme një dem me karakter pasuror.



Fajësia ne veprimet e paligjshme konsiston ne kryerjen e veprimeve me faj të kryera nga shoqëria e paditur që realizoi në importimin e mallrave të ngjashme me markën tregtare në pronësi të shoqërië paditëse, ndërkohë që një sasi mallrash ishte importuar nga personi i tretë në gjykim dhe ky fakt ndryshe nga sa pretendon pala paditëse provohet sipas përmbajtjes së deklaratës doganore e cila për sa përmban në përmbajtjen e saj përbën provë të plotë dhe në këto rrethana lidhur dëmin e ardhur nga shitja e këtyre patatinave sipas deklaratës doganore të datës 04.09.2013, personi i tretë në emër të të cilit është lëshuat deklarata doganore nuk gëzon as legjitimin pasiv për tu detyruar të dëmshpërblejë paditësin.

d) ekziston lidhja shkakesore mes demit dhe veprimit te paligjshem.

Lidhja shkaksore si element i pergjegjise juridiko- civile ne shkaktimin e demit nenkupton se demi eshte rrjedhoje e drejteperdrejte dhe e menjehershme e veprimi ose mosveprimit te paligjshem.

Gjithashtu gjykata vlerëson se nuk u vërtetua gjatë hetimit gjyqësor egzistenca e lidhjes shkasore mes demit të pretenduar se i ka ardhur paditësit në masën \*\*\* lekë dhe veprimeve me faj të kryera nga shoqëria e paditur që realizoi importimin e mallrave të ngjashme me markën tregtare në pronësi të shoqërië paditëse. Dëmi nënkupton që të jetë rrjedhojë e drejtëpërdrejtë dhe e menjëhershme e veprimeve të të paditurit dhe në rastin në gjykim ky dëm i pretenduar, në formën e fitimit në munguar, që përfaqëson vlerën që do të kishte arkëtuar shoqëria nga shitja e 39 306, 5 qese patatinash nuk mund të rrjedhojë i veprimeve të të paditurit.

Për sa më sipër, në kushtet kur pala paditëse nuk mund te vertetoje masën e demit si dhe lidhjen shkaksore, atherë nuk plotësohen për palën paditëse të gjitha kushtet e përcaktuara në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i demit, përgjegjesinë e nje personi për dëmin e shkaktuar dhe për pasojë nuk përlligjet kërkimi i paditësit për shpërblimin e demit.

Bazuar në nenin 104 e vijues të K Pr Civile shpenzimet gjyqësore të evidentuara taksa e padisë në masën 3 000 lekë dhe shpenzimi i avokatit të palës paditëse sipas faturës tatimore të shitjes të datës 29.01.2014 me nr. \*\*\* në masën \*\*\*lekë dhe faturës tatimore të shitjes 28.05.2018 me nr. \*\*\* në masën \*\*\*lekë bazuar në nenin 106 e vijues të K Pr Civile ju ngarkohen proporcionalisht palëve.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata në bazë të 306 të K.Pr.Civile;

**VENDOSI**

Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

Deklarimi i paligjshëm i aktivitetit tregtar të importimit dhe qarkullimit në tregun shqiptar të produkteve “\*\*\*\*” nga shoqëria e paditur “\*\*\*\*” sh.p.k dhe pushimi i cënimit të të drejtave të markës tregtare “\*\*\*\*” të paditësit.

Ndalimi i shoqërisë së paditur “\*\*\*\*” sh.p.k të importojë /eksportojë ,hedhë në tregun shqiptar, ofrojë për shitje ose krijojë rezerva për këto qëllime, të mallrave patatina “\*\*\*\*”.

Ndalimi i shoqërisë së paditur “\*\*\*\*” sh.p.k të ofrojë shërbime dhe të përdorë në veprimtari tregtare, në reklamime ose publicitete etiketën “\*\*\*\*”.

Bllokimi dhe shkatërimi me shpenzimet e shoqërisë së paditur “\*\*\*\*” sh.p.k të të gjithë produkteve patatina “\*\*\*\*” të imortuara dhe të shpërndara në tregun shqiptar (me pakicë ose shumicë) dhe që mund të gjenden tek çdo subjekt tregtar ose në magazina ose në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë.

Urdhërimin e shoqërisë së paditur “\*\*\*\*” sh.p.k të japë informacion në lidhje me orgjinën dhe rrjetin shpërndarës të patatinave “\*\*\*\*” që cënojnë markën tregtare “\*\*\*\*”.

Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.

**Shpenzimet gjyqësore ju ngarkohen proporcionalisht palëve.**

**Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për këtë vendim gjyqësor.**

**Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit për palën paditëse dhe për të paditurin dhe personin e tretë në mungesë afati fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.**

**U shpall sot më datë 20.06.2018.**

**SEKRETARE**

**ERALDA BENDO**

**ANILA KRISTANI**

**GJYQTARE**

**Shpenzimet gjyqësore**

**Takse regjistrimi**

**Shpenzime avokati i palës paditëse**

**Totali**

**\*\*\*lekë**

**\*\*\*lekë,**

**\*\*\*lekë.**